

## Çka është NMU

NMU është shkurtesë për «Këshillin e komunitetit lokal» (Nærmiljøutvalg)

Në komunën e Sandefjordit ekziston nga një këshill i komunitetit lokal për secilin distrikt të shkollave të ciklit të ulët. Këshillat e komuniteteve lokale punojnë vullnetarisht brenda skemës së demokracisë lokale në komunën e Sandefjord-it. Ju jeni të mirëspritur që të merrni pjesë.

- A doni të përmirësoni zonat e afërta ku kalojnë kohën fëmijët tuaj?
- A doni të përfshiheni në vendime që vlejné për zonën tuaj dhe komunën tuaj?

Detyrat e një Këshilli të komunitetit lokal (NMU) janë:

- Të zhvillojë kushte të mira rritjeje për fëmijë dhe të rinj
- E drejta e deklaramit për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me banorët e komunitetit lokal, pavarësisht grupmoshës
- Të marrë pjesë në takime dialogu midis përfaqësuesve të zgjedhur të komunës dhe administratës së komunës
- A jeni i preokupuar për trafikun, ndërtimin e banesave, hapësirat e gjelbra, këndet e lojërave, aktivitete që mund t'i kryeni së bashku me të tjerë, shtigje për shëtitje ose për gjëra të tjera?

Kontaktoni Këshillin e komunitetit tuaj lokal.

Komuna e Sandefjordit për çdo vit ndan grante për Këshillat e komuniteteve lokale. Këshillat e komuniteteve lokale vendosin vetë se si t'i përdorin këto grante.

Ju mund të gjeni informata për Këshillat e komuniteteve lokale dhe për skemën e demokracisë lokale këtu:

[www.sandefjord.kommune.no/nardemokrati](http://www.sandefjord.kommune.no/nardemokrati)

